



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 749 Akti

Nr. 765 Vendimi  
Tiranë, më 21.5.2024

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	Kryesues
<b>Xhensila Pine</b>	Relatore
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Anëtare

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 21.5.2024, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Alma Tafani**, me detyrë ndihmëse ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme.

**BAZA LIGJORE:**

- Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Neni G** i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017**, i Gjykatës Kushtetuese.

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), znj. Alma Tafani ushtronte detyrën e ndihmëses ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në bazë të nenit 179/b/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë iu nënshtrua procesit të rivlerësimit, për shkak të statusit të saj *ex officio*.

**2.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në qershor të vitit 2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, ka shortuar subjektin e rivlerësimit për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Genta Tafa (Bungo) dhe Xhensila Pine (relatore e çështjes). Me mirëkuptim, kryesues i trupit gjykues u caktua komisioner Roland Ilia. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mungesën e konfliktit të interesit.

**3.** Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga Komisioni u verifikua se subjekti ka plotësuar dhe depozituar deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

**3.1** Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

**4.** Trupi gjykues, i shortuar në Komision, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, duke iu dërguar pyetëtori standard dhe përbërja e trupit gjykues. Subjekti deklaroi se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

**5.** Në datën 3.5.2024, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin se në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës, nenit 209 dhe nenit 211, pika 2 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është emëruar në detyrën e inspektorit jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke paraqitur edhe urdhrin përkatës të emërimit të saj në këtë detyrë prej muajit shkurt 2021.

**6.** Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë dorëheqjen nga detyra e ndihmëses ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme në datën 8.2.2021. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.5.2024, ka vënë në dispozicion të Komisionit praktikën, e cila përmban: (i) kërkesën për dorëheqje nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021, të subjektit; (ii) urdhrin nr. \*\*\*, datë 8.2.2021, “Për lirim nga detyra të znj. Alma Tafani” duke njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare datën 8.2.2021.

**7.** Komisioni, pasi ka administruar praktikën e dorëheqjes së subjektit nga detyra e ndihmëses ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në mbështetje të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 e ka informuar subjektin mbi statusin ligjor që gëzonte në këtë fazë të hetimit dhe rezultatin e ndërprerjes së procesit të saj të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë duke e njoftuar dhe për të drejtën që ajo gëzonte për të shprehur qëndrimin e saj.

**8.** Gjithashtu, Komisioni e ka informuar subjektin lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar në seancën dëgjimore dhe subjekti i rivlerësimit, më 15.5.2024, me anë të rrugës elektronike, ka njoftuar Komisionin se duke u ndodhur para faktit të mosushtrimit të detyrës nga ana e saj kërkonte ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe se nuk dëshironte të merrte pjesë në seancën dëgjimore.

## II. PËRFUNDIMI I PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

9. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar në respektim të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit Alma Tafani ka ushtruar detyrën e ndihmësës ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016;
- ii. Subjekti i rivlerësimit Alma Tafani ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016;
- iii. Prokuroria e Përgjithshme, urdhrin nr. \*\*\*, datë 8.2.2021, ka vendosur lirim nga detyra dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës së subjektit të rivlerësimit.

10. Dispozitat kalimtare të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, parashikojnë se: “2. *Këshilltari ligjor vazhdon të qëndrojë në detyrë përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar*”.

11. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: “1. *Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare*”.

12. Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon: “1. *Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit. 2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1 e ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”*”.

13. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe orientimin e dhënë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 17/2019 (JR), bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni, në rrugë elektronike, në datën 8.5.2024, ka njoftuar subjektin mbi statusin ligjor që gëzonte në këtë fazë të hetimit duke e njoftuar se ajo kishte kohë deri në datën 15.5.2024, për të paraqitur shpjegime e për të deklaruar nëse kishte vullnetin për të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

14. Subjekti i rivlerësimit, në datën 15.5.2024, me anë të rrugës elektronike ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

15. Trupi gjykues mban parasysh jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës akti i dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë humbjen e statusit të tij si subjekt rivlerësimi *ex officio*, në kuadër të përcaktimit kushtetues të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe

pamundësinë e realizimit të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që, referuar nenit 58, pika 1, nënparagrafët “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1 të nenit 179/b të Kushtetutës, përfundimisht realizohet nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

**16.** Vullneti për të mos iu shmangur procesit të rivlerësimit, sipas përcaktimit të tij në dispozitat kushtetuese dhe në ligjin nr. 84/2016, shprehet vetëm nëpërmjet qëndrimit në detyrë dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit. Në momentin që subjekti i rivlerësimit me vullnetin e saj të lirë ndërpret detyrën funksionale, që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

**16.1** Në të njëjtën linjë arsyeton edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, ku shprehet: *“Për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”*.

**17.** Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit Alma Tafani ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje nga detyra e ndihmëses ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj, duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.

**18.** Ky është një qëndrim i unifikuar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimmarrje të mëparshme, sipas të cilave orientohet Komisioni që, në këto raste, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit G, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

**19.** Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit Alma Tafani, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Alma Tafani.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Alma Tafani si gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 21.5.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
Kryesues

**Xhensila PINE**  
Relatore

**Genta TAFA (BUNGO)**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*